



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA HAS**

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdania, Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Faks; 035521422080. E-mail; bashkiakrumë@yahoo.com

KONTRATE

NR.1305, Date 24.06.2016

**PER MBIKQYRJEN E PUNIMEVE NE OBJEKTIN
"Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has"**

E lidhur sot me date 24.06.2016, midis Bashkise Has, perfaqesuar nga Kryetari, z. Adem Lala dhe mbikqyresit te punimeve, shoqerise "ARGI" sh.p.k. , me Licence me Nr. MK 1666, date 02.03.2009, me administrator, z. Llambi Tarka, per mbikqyrjen e punimeve te ndertimit te objektit "Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has".

Kjo Kontrate lidhet mbeshtetur ne Udhëzimin e Keshillit te Ministrave Nr. 3, date 15.02.2002 dhe ndryshimet, per te bere te mundur mbikqyrjen e punimeve te kontrates se ndertimit te objektit mbeshtetur ne daljen fitues te shoqerise "ARGI" sh.p.k. nepermjet prokurimit te sherbimit te mbikqyrjes..

1 OBJEKTIVI I KONTRATES

Kryerja e sherbimit te Drejtimit te Punimeve te ndertimit te objektit "Rehabilitimi i Godinave, Shesheve dhe Qendrës se Qytetit Krumë-Has", me Investitor Bashkine Has.

2. VENDI I NDERTIMIT

Vendi i kryerjes se punimeve eshte: Qyteti i Krumes.

3. DATA E FILLIMIT TE PUNIMEVE

Sherbimi eshte ne vazhdim me lidhjen e kontrates te mbikqyrjes se punimeve te ndertimit te objektit, me afat 150 dite.

4. ADMINISTRIMI I KONTRATES

Mbikqyresi i punimeve eshte pergjegjes per administimin e Kontrates se ndertimit te objektit lidhur midis Investitorit dhe Sipermaresit.

5. GJUHA DHE LEGJISLACIONI



Gjuha e perdorur ne formulimin e kesaj Kontrate dhe te cdo dokumentacioni tjeter qe lidhet me te eshte gjuha shqipe.

Ligji qe aplikohet mbi cdo gje qe lidhet me kete kontrate eshte Legjislacioni Shqiptar.

6. KOMUNIKIMI

Komunikimi midis paleve neneshkruese te kesaj Kontrate mer forme ligjore vetem kur behet me shkrim dhe pasi te jete dorezuar.

7. PERGJEGJESITE E MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE

Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat kryesore ndertimin e objektit dhe eshte pergjegjes per saktesine dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te.

Me rastin e fillimit te punimeve Mbikqyresi i punimeve verifikimet paraprake si me poshte:

Verifikon sheshin e ndertimit ne eshte i lire dhe gatshem per fillimin e punimeve dhe ja dorezon ate Sipermaresit.

Njohjen me hollesi te Kontrates se sipermarjes dhe te gjitha aktet administrative qe lidhen me te, si dhe te njohe te gjitha ndryshimet e mundeshme qe mund te pesoje kjo Kontrate.

Mbikqyresi i Punimeve kontrollon dokumentacionin teknik qe mbahet nga sipermarsi per pasqyrimin e realizimit te punimeve te ndertimit.

Mbikqyresi i Punimeve jep instruksione per zbatimin e projektit dhe ndjek proceduren e ndertimit sipas zerave dhe ne total te punimeve, per te siguruar cilesine e nevojeshme te zbatimit te punimeve.

Mbikqyresi i Punimeve kontrollon zbatimin e grafikut te punimeve dhe afatet duke i raportuar investitorit.

Mbikqyresi i Punimeve harton dhe jep relacion per ecurine e punimeve.

Mbikqyresi mer pjese ne asistencen dhe ndihmen per furnizimet me materialet qe do te perdoren ne objekt, duke perfshire kontrollin per karakteristikat e tyre sipas projektit dhe specifikimeve teknike te ndertimit te rrugeve.

Mbikqyresi i Punimeve ben vleresimin e koston te korigjimit te defekteve duke i pasqyruar me process verbalet perkates.

Ne rast se Sipermaresi nuk ben korigjimet e nevojeshme brenda afeteve qe caktohen ne njeftimin e Mbikqyresit, ky i fundit ve ne dijeni investitorin duke propozuar edhe masat e nevojeshme qe duhet te meren ndaj Sipermaresit.

Mbikqyresi i Punimeve ka te drejte ti rekomandoje Investitorit pezullimin e perkohshem te punimeve ne rast se Sipermaresi ben shkelje themelore te Kontrates se Sipermarjes.

Mbikqyresi i Punimeve mban dosjen e mbikqyrjes se punimeve ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtura gjate zbatimit te punimeve. Ne rast te nderimit te Mbikqyresit te Punimeve mbahet proces verbali i dorezimit te dosjes se punimeve ku shenohen edhe shkaqet e ketij nderimi.



Efektet financiare per mbikqyresin e vjeter vleresohen ne baze te perqindjes se vleresimit te Kontrates se mbikqyrjes dhe realizimit te punimeve sipas Kontrates se Sipermarjes deri ne kete moment, duke zbritur paradheniet e mara.

Ne perfundim te kryerjes se punimeve, sipermaresi njofton Mbikqyresin e Punimeve per perfundimin e punimeve, ben deklarimin e zbatimit te projektit, Kushtet Teknike te Zbatimit dhe pergatit dosjen e dokumentacionit te realizimit te punimeve. Kjo dosje i dorezohet Mbikqyresit te Punimeve.

Mbikqyresi i Punimeve i dergon njoftimin me shkrim Investitorit per perfundimin e punimeve te ndertimit te objektit.

Mbikqyresi i Punimeve mer pjese ne kolaudimin e punimeve te objektit, i pergjigjet kolaudatorit duke dhene shpjegime per dokumentacionin, menyren e kryerjes se punimeve dhe kontrollin ndaj fondeve.

Situacionet e paraqitura nga Sipermaresi ne faza te ndryshme te realizimit te punimeve kontrollohen dhe aprovohen nga Mbikqyresi i Punimeve mbi bazen e matjeve faktike te pasqyruara ne librin e objektit dhe bazuar ne cmimet e ofertuara dhe te pranuar.

Mbikqyresi i Punimeve kontrollon perdorimin e fondit reserve dhe argumenton nevojen e perdorimit te tij para Investitorit.

Kur verehen shkelje te rrenda te dispozitave ligjore, Investitori ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e Punimeve per nderprerjen e e punes deri ne marjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes.

Mbikqyresi i Punimeve pergjigjet ne baze te dispozitave ligjore per demet e shkaktuara Investitorit nga veprimet apo mosveprimet e tij gjate mbikqyrjes se punimeve te ndertimit te objektit.

8. PERGJEGJESITE E INVESTITORIT

Investitori siguron kushte normale te domosdoshme per zbatimin e detyrimeve per Mbikqyresin e Punimeve.

Investitori ben pagesen e Mbikqyresit te Punimeve rregullisht sic eshte caktuar ne kete Kontrate.

9. PAGESAT

Vlefta e kryerjes se sherbimit te Mbikqyrjes se Punimeve te shteses se kontrates eshte **790.000** (shtate qint e nente dhjete mije) leke pa TVSH dhe **948.000** (nenteqint e dyzet e tete mije) leke me TVSH.

Pagesat nga Investitori do te behen ne llogarine: "**ARGI**" sh.p.k, ne **BKT**, Dega "**Rr. Ismail Qemali**", **Tirane**, me numur llogarie **Nr. 402086299**, dhe **IBAN ne leke AL1420511021086299CLCPCLALLA**.

Pagesa pjesore, ne rast se kerkohe mbi bazen e nje fature qe Mbikqyresi i dorezon Investitorit, behet mbi bazen e perqindjes se realizimit te punimit te ndertimit.

Pagesa perfundimtare e ketij sherbimi behet me perfundimin e punimeve te ndertimit.



10. ZGJIDHJA E MOSMAREVESHJEVE

Investitori dhe Mbikqyresi i Punimeve duhet te bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur ne menyre paqesore dhe me bisedime te ndonje mosmareveshjeje qe mund te linden gjate ushtrimit te aktivitetit.

Ne qofte se mosmareveshja vazhdon, secila pale mund te drejtohet Gjykates se Faktit te Qaekut Kukës.


Kjo Kontrate u hartua ne tre kopje, nga te cilat nje per mbikqyresin e punimeve dhe dy per Investitorin.

Sot me date 34.06.2016, palet bien dakort per nenskrimin e kesaj kontrate.

BASHKIA HAS

KRYETARI

Adem LALA



MBIKQYRESI I PUNIMEVE

“ARGI” sh.p.k

Llambi TARKA

